

VENDIM
Nr. 780, datë 14.11.2012

PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 848, DATË 21.10.2010 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE “PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE TË
PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA NDËRTIMI I LINJËS
400 KV TIRANË 2 - ELBASAN 2, QARKU I ELBASANIT”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5 pika 1, 20 e 21 të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999 “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik”, me propozimin e Zëvendëskryeministrit dhe Ministër i Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Pikat 3 dhe 4 të vendimit nr. 848, datë 21.10.2010 të Këshillit të Ministrave, ndryshohen si më poshtë vijon:

“3. Pronarët e pasurive të paluajtshme, që shpronësohen, të kompensohen në lekë, në vlerë të plotë, sipas masës përkatëse të kompensimit, që paraqitet në tabelën që i bashkëlidhet këtij vendimi, për sipërfaqen e përgjithshme 5 832.7 (pesë mijë e tetëqind e tridhjetë e dy pikë shtatë) m², vlerësuar në shumën e përgjithshme prej 138 274 629.6 (njëqind e tridhjetë e tetë milionë e dyqind e shtatëdhjetë e katër mijë e gjashtëqind e njëzet e nëntë pikë gjashtë) lekësh.

4. Vlera e përgjithshme e shpronësimit prej 138 274 629.6 (njëqind e tridhjetë e tetë milionë e dyqind e shtatëdhjetë e katër mijë e gjashtëqind e njëzet e nëntë pikë gjashtë) lekësh, të përballohet nga fondet e OST sh.a.”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha